



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:067422

Datë: 30.05.2019

Numri i dokumentit: 00338211

P.nr.1854/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Fidan Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional Shqipron Sedolli, në çështjen penale ndaj të akuzuarit E. Sh nga, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.1113-4/18 të datës 03.10.2018, në shqyrtimin fillestar me shqyrtim të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në prezencën e prokurorit të shtetit Ramadan Koro, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. Gent Gjini nga Prizreni, me datë 27.05.2019, publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 28.05.2019 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.SH, nga i ati S. dhe e ëma N, e lindur B., i lindur më datë ... në ..., ku edhe tani jeton, në rrugën “...” pa nr, punëtor fizik, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 01.05.2018, rreth orës 18:10 min, në ..., saktësisht në rrugën “...” pa autorizim ka poseduar narkotik, substancë psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli nga patrulla e stacionit policor në kanë ndaluar të dyshuarin E. Sh dhe tek i njëjti janë gjetur dy qese të vogla me substancë të dyshuar për lëndë narkotike e llojit “Marihuanë” me peshë 3.61 gram.

Me këto veprime ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, dhe substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 41, 46, 49, 50, 51, 62 par.2 nën par. 2.6, 73 dhe nenit 275 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton dënimin dhe atë:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 euro, i cili dënim do të paguhet në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata të njëjtit do të ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim ashtu që për 20 (njëzetë) euro të gjobës ia llogaritë 1 (një) ditë burgim.

Dënim plotësues

Të akuzuarit, në kuptim të nenit 275, par. 1 të KP-së, lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.6, të KP-së i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në sasi prej 3.61 gram.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej 30 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1113-4/18 të datës 03.10.2018, ndaj të akuzuarit E. Sh nga, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 të KPRK-së.

Me datë 19.11.2018 prokurori i shtetit ka parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, hartuar nga ana e prokurorit të shtetit në pajtim me të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij Avokat G. Gj.nga

Në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë e hartuar nga ana e prokurorit të shtetit me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku në mes tjerash është negociuar dhe propozuar dënimi për të akuzuarin. Në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në dispozitivin nën IV. është rekomanduar dënimi me gjobë në lartësi prej 200 euro dhe dënimi me kusht prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar me marrëveshje mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes me shkrim të lidhur mes prokurorit të çështjes dhe të pandehurit në prezencë të mbrojtësit të tij dhe kërkohet nga gjykata që

të njëjtën ta aprovoj si është shkruar me propozimet që kemi dalë, sa i përket dënimit gjykata të aprovon si është cekur në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. Sh – Avokati G.Gj deklaroj se: gjatë konsultimit me të mbrojturin tim të cilin e kam njoftuar me marrëveshjen për pranimin e fajësisë e cila është përpiluar konform dispozitave ligjore nga ana e prokurorit të çështjes, i propozoj gjykatës që ta aprovon marrëveshjen në tërësi të datës 19.11.2018, sa i përket dënimit i propozoj gjykatës të vendos ashtu si është rekomanduar në marrëveshje.

I akuzuari E. Sh deklaroi se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të mbrojtësit të tij.

Ndër të tjera gjatë shqyrtimit fillestar me marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se me datë 01.05.2018, rreth orës 18:10 min, në ..., saktësisht në rrugën "...." pa autorizim ka poseduar narkotik, substancë psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli nga patrulla e stacionit policor në ... kanë ndaluar të dyshuarin E.Sh dhe tek i njëjti janë gjetur dy qese të vogla me substancë të dyshuar për lëndë narkotike e llojit "Marihuanë" me peshë 3.61 gram.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare në harmoni me nenin 257 të KPPK, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme e cila është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore e cila do të vinte në dyshim dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë – marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 253 të KPPK, të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë shqyrtimit fillestar të marrëveshjes për pranim të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç 'rast nga ana e të akuzuarit në mënyrë vullnetare është pranuar fajësia, pa kushtëzime, pa presione dhe askush nuk ka bërë premtim të kundërligjshëm i cili do ti shtyjë në pranimin e marrëveshjes, por e gjithë kjo është bërë pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e neneve 233, 246 dhe 248 të KPPK. Gjykata gjithashtu nga i akuzuari ka vërtetuar se marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e ka pranuar pa asnjë presion me vullnet të plotë dhe heq dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt. Sa i përket vendimit mbi dënimin prokurori i shtetit i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, propozuan gjykatës që të aprovoj dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, respektivisht rrethanat e përcaktuara me nenin 73 të KPK erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana tejet lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga ana e akuzuarit. Andaj, bazuar në rrethanat e lartë – theksuara gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha pikat e saja, me ç 'rast të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin e rekomanduar, ashtu që i shqiptoj dënimin me gjobë dhe dënimin me kusht duke menduar

se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjesisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që i akuzuari në të ardhmen të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Të akuzuarit konform nenit 275 par.1 të KP-së lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.6, i është shqiptuar dënimi plotësues dhe i është konfiskuar substanca narkotike e llojit marihuanë në sasi prej 3.61 gram.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në pajtim me nenin 453 të KPPK.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:067422, 28.05.2019

G j y q t a r i

Fidan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.